



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ**

Numri i lëndës: 2022:281540

Datë: 22.02.2023

Numri i dokumentit: 04002369

**PPP.nr.202/2022**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm**, si përbarimore, gjyqtari Avdulla Mecinaj me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike të kreditorit KUR “Mitrovica” Sh.a., J.S.C., me adresë “Rruga e Liqenit” pn.- Mitrovicë, kundër debitorit Z.K., me vendbanim në Skenderaj, për shkak të borxhit në shumë prej 179.10 euro, duke vendosur sipas propozimit të ushtruar nga debitori kundër urdhrit përbarimor P.nr.339/22 të dt.01.12.2022, jashtë seancës gjyqësore, me dt.22.02.2023, jep këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar propozimi i debitorit Z.K., me vendbanim në Skenderaj, ushtruar kundër urdhërit mbi lejimin e përbarim P.nr.339/22 të dt.01.12.2022, sipas propozimit të kreditorit KUR “Mitrovica” Sh.a., me adresë “Rruga e Liqenit” pn.- Mitrovicë.

**II.** Mbetet në fuqi Urdhri përbarimor i përbaruesit privat P.nr.339/2022 i dt.01.12.2022.

**A r s y e t i m**

Kreditori KUR “Mitrovica” Sh.a., me adresë “Rruga e Liqenit” pn.- Mitrovicë, ka ushtruar propozimin për përbarim të përbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj debitorës Z.K., me vendbanim në Skenderaj, për pagesën e borxhit për shërbimet e furnizimit me ujë, për periudhën kohore dt.01.01.2021 deri me dt.30.11.2022 në shumë prej 179.10 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e arritshmërisë për pagesë, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrit, në të kundërtën nëse debitori nuk posedon mjete

monetare në llogarinë bankare zyra përbarimore përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe mjetet e mbledhura të transferohen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përbarim të dt.30.11.2022.

Përbaruesi privat I.M. nga Mitrovica, me urdhrin përbarimor P.nr.339/22 të dt.01.12.2022, e ka lejuar propozimin për përbarim në këtë çështje përbarimore.

Debitori, Z.K., brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar urdherin me anë të cilit është lejuar përbarimi me pretendimin se kreditori nuk ka dëshmuar faturat në bazë të të cilave është lejuar përbarimi, nuk ka asnjë provë që janë dërguar në procedurë të rregullt dhe se është bërë shfrytëzimi i mbeturinave në shumën si në fatura, poashtu debitori nuk ka dhanë asnjë argument se në bazë të cilës kontratë të lidhur me debitorin i ka bazuar këto fatura, më tutje shtoj se gjendja e rëndë socio-ekonomike nuk ia mundëson kreditorës që t'i kryej obligimet, sepse është rast social, poashtu deklaroj se borxhi është parashkruar duke u bazuar në dispozitat e nenit 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, andaj i propozoj gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohen dhe të pezullohen të gjitha veprimet e ndërmarra si të kundërligjshme.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoi si të pabazuar për faktin se fillimisht kreditori propozimin për përbarim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm të parapara me dispozitat e nenit 29 të LPP-së, kurse sa i përket pretendimeve të debitorit i cili thirret në parashkrim këtu nuk kemi të bëjmë me parashkrim, për arsye se borxhi i kërkuar i takon periudhave nga dt.01.01.221 e gjer me dt.30.11.2022, ndërsa për borxh tjetër nuk kemi kontest, ndërsa sa i përket gjendjes së rëndë ekonomike le të lajmërohet në Qendrën për Punë Sociale. Debitori i ka pranuar rregullisht shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve nga kompania, mirëpo ne si kompani nuk kemi pasur asnjëherë ankesë nga ana e debitorit se nuk po i ofrohen shërbimet me rregull, si provë përgjigjes i bashkangjesim ekstraktin financiar ku shihet se debitori i ka pranuar faturat dhe periudhat lidhur me borxhin me të cilin ngarkohet, andaj konsideroj se propozimi i kreditorit duhet të përmbushet konform nenit 27 par. 1 dhe 29 par.1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Gjykata Themelore Mitrovicë – Dega në Skenderaj, si përbarimore, në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pabazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përbarimore, sipas të cilave do të pengohej përbarimi i lejuar nga kjo gjykatë.

Gjykata pas shikimit të shkresave tjera të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë kreditori nuk ka dëshmuar faturat në bazë të të cilave është lejuar përbarimi, nuk ka asnjë provë që janë dërguar në procedurë të rregullt dhe se është bërë

shfrytëzimi i mbeturinave në shumën si në fatura, poashtu debitori nuk ka dhanë asnjë argument se në bazë të cilës kontratë të lidhur me debitorin i ka bazuar këto fatura, pretendimet e lartëcekura gjykata i refuzoj si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka iniciuar në bazë të faturës, e sipas nenit 29 par.1.3 në lidhje me par.3 të LPP-së, fatura konsiderohet dokument i besueshëm dhe është i përshtatshëm për përmbarim, po ashtu në shkresat e lëndës gjendet kartela financiare e konsumatorit që i është bashkangjitur propozimit për përmbarim ku janë të specifikuara të dhënat si: kreditori, debitori, adresa, data, vendi, sasia e ujit të harxhuar, vlera në euro, pagesat eventuale, si dhe borxhi i përgjithshëm, poashtu në propozimin për përmbarim është specifikuar qart se borxhi i kërkuar është nga dt.01.01.2021 e deri me dt.31.10.2022 në shumën prej 179.10 euro, ndërsa borxhi para kësaj periudhe nuk është objekt kontesti, si dhe debitori nuk ka bashkangjitur prapësimin asnjë dëshmi lidhur me pretendime siç parashifet me dispozitat e nenit 69 par. 4 të LPP-së ku shprehimisht thuhet se “Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”.

Pretendimet e debitorit lidhur me gjendjen ekonomike të të njëjtit, gjykata në rastin e vendosjes sipas prapësimin nuk mund t'i merr parasysht, mirëpo të njëjtat pretendime do të mund të shqyrtoheshin gjatë zhvillimit të procedurës së tentim përmbarimit nga përmbaruesi privat si organ përmbarues në këtë rast, i cili do të vlerësoj nëse do të mund të aplikohen dispozitat e kufizimit apo përjashtimit nga përmbarimi.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se borxhi është parashkruar, gjykata gjeti se te njëjtat pretendime janë të pabazuara, për faktin se kreditori në propozimin për përmbarim e ka kërkuar borxhin për periudhën kohore dt.01.01.2021 gjerë më dt.30.11.2022, e duke u bazuar në nenin 360 par.1 dhe 2 e në lidhje me nenin 368 nuk kemi parashkrim të këtij borxhi, për shkak se kreditori me dt.30.11.2022 e ka ngritur propozimin për përmbarim, e ku është ndërprerë edhe afati i parashkrimit.

Se debitori i obligohet kreditorit si në propozim për përmbarim këtë fakt gjykata, e mbështetë në nenin 245 par.1 të LMD-së i cili nen parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjykata konfirm nënitet 17 të LPP-së, aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 par.1.3 dhe par.3, 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, 369 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**PPP.nr.202/2022, dt.22.02.2023**

**Gj y q t a r i**  
**Avdulla Mecinaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij Aktvendimit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.